



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:017081

Datë: 18.12.2023

Numri i dokumentit: 05083170

Ep.nr.49/2022

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtarja Blerta Kelmendi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit K “A”, SH.A, me adresë rruga ”F. U”, nr....., Pejë, ndaj debitorit I. (O) K nga fshati V, i Komunës së Pejës, me bazë juridike përmbarimore pagesa e borxhit në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit kundër Urdhrit të Përmbauesit Privat Shpend Ahmetaj, me seli në Pejë, P.nr./I.Br.254/17, i datës 03.11.2017, jashtë seancës gjyqësore, me datë 18.12.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET PJESËRISHT SI I BAZUAR, prapësimi i debitorit I. (O) K, nga fshati V, i Komunës së Pejës, ashtu që SHFUQIZOHET pjesërisht Urdhri i Përmbauesit Privat Shpend Ahmetaj, me seli në Pejë, P.nr./I.Br.254/17, i datës 03.11.2017, sa i përket shumës së borxhit në lartësi prej 238.25 euro.

II.REFUZOHET I PABAZUAR, pjesa tjetër e prapësimit të debitorit dhe MBETET NË FUQI Urdhri Përmbarimor i Përmbauesit Shpend Ahmetaj, me seli në Pejë, P.nr./I.Br.254/17, i datës 03.11.2017, sa i përket shumës prej 93.00 euro.

A r s y e t i m

Kreditori K “A”, SH.A., me seli në Pejë, me datë 03.11.2017, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm- ekstraktet e verifikuara nga librat

afariste për pagesat e shërbimeve të bartjes së mbeturinave, për periudhën kohore nga data 01.01.2012 e deri më 30.09.2017, në shumën prej 331.25 euro.

Përmbaruesi Privat duke vendosur në bazë të propozimit të kreditorit, ka nxjerrë Urdhrin P.nr./I.Br.254/17, i datës 03.11.2017, duke lejuar përmbarimin e propozuar.

Debitori në afatin e lejuar ligjor, me datën 30.12.2021, ka parashtruar prapësim kundër këtij urdhri përmbarimor, me arsyetimin se kërkesa e kreditorit është parashkruar në kuptim të nenit 360 të LMD-së, i cili parasheh që kërkesa për furnizim me energji eklektike, gaz, ujë dhe shërbimet e mirëmbajtjes parashkruhen pas një viti. Debitori ka theksuar se faturën për borxh nuk e ka pranuar deri me datën 23.12.2021, pasi që në fshatin V nuk jeton më që nga paslufta, por jeton në Pejë, në rrugën A J, duke i propozuar gjykatës që ta anuloj urdhrin përmbarimor ndërsa prapësimin ta aprovoj si të bazuar.

Kreditori lidhur me pretendimet në prapësim nuk ka dhënë përgjigje në prapësim.

Gjykata në procedurën përmbarimore pasi ka shqyrtuar dhe vlerësuar prapësimin e palës debitore, si dhe shkresat e tjera të lëndës, ka gjetur se prapësimi është pjesërisht i bazuar.

Shqyrtimi i ligjshmërisë të urdhrin përmbarimor dhe dokumentit të besueshëm.

Në propozimin për përmbarim të kreditorit të datës 03.11.2017, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Shpend Ahmetaj, me seli në Pejë, P.nr./I.Br.254/17, i datës 03.11.2017, në bazë të dokumentit të besueshëm-ekstrakti nga librat afariste, nga ana e kreditorit është kërkuar borxhi për periudhën kohore nga data 01.01.2012 e deri më 30.09.2017, në shumën prej 331.25 euro, në emër të bartjes së mbeturinave.

Gjykata pas vlerësimit të dokumentit të besueshëm-ekstraktit nga librat afariste, mbi bazën e të cilit është filluar procedura përmbarimore, konsideron se i ka plotësuar të gjitha kushtet ligjore në kuptim të dispozitës së nenit 29 par.1 pika 1.2 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (tutje LPP-së), që përcakton shprehimisht se: *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.1. kambialet dhe çeket me potest dhe faturë kthyese, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës; 1.2. ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*.

Në këtë drejtim, dokumenti i besueshëm, mbi bazën e së cilës është aprovuar edhe urdhri për përmburim është i ligjshëm dhe në harmoni me par.3 të nenit 29 të LPP-së, që përcakton se *“Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmburim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmburjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata pas konstatimit të ligjshmërisë të urdhrin përmburimor, gjen se prapësimi i debitorit se kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës së kreditorit për arkëtimin e borxhit në rrugë gjyqësore, është pjesërisht i bazuar, konform nenit 378 par.1 të LMD-së së ish-RSFJ-së dhe nenit 360 par.1 të LMD-së.

Gjykata parashkrimin e borxhit për periudhën nga 01.01.2012 e deri më 18.12.2012, ka zbatuar dispozitat e LMD-së të ish-RSFJ-së (i vitit 1978), si ligj në fuqi në kohën kur është krijuar marrëdhënia juridike civile, kurse nga 19.12.2012 e tutje, gjykata ka zbatuar dispozitat e Ligjit nr.04/L-077- të Marrëdhënieve të Detyrimeve (të vitit 2012).

Gjykata konstaton se kreditori për një pjesë të kërkesës ka humbur afatin ligjor brenda të cilit do të mund të arkëtonte forcërisht borxhin përmes rrugës gjyqësore, saktësisht për borxhin që përfshin periudhën kohore nga data 01.01.2012 e deri më 31.12.2015 në shumë prej 238.25 euro për shkak të parashkrimit.

Kreditori propozimin për përmburim, e ka paraqitur më datën 03.11.2017 dhe sipas vlerësimit të gjykatës, borxhi i krijuar nga ana e debitorit që nga data 01.01.2012 e deri më 31.12.2015 është parashkruar, sepse ka kaluar afati 1 vjeçar brenda së cilës kreditori ka pasur mundësi të kërkojë përmburjen gjyqësore të detyrimit, referuar nenit 378 të LMD-së të ish-RSFJ-së: *“Parashkruhen për një vjet: kërkesa e kompensimit për livrimin e energjisë elektrike e të ngrohjes, gazit, ujit dhe shërbimet e spastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e pastërtisë, kur livrimi, respektivisht shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”* dhe nenit 360 par.1 pika 1.1 dhe par.2 dhe 3 të LMD-së që përcakton se *“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: 1.1. kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake; 2. Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë. Kurse neni 341 par.1 i LMD-së përcakton se “Me parashkrim shuhet e drejta e kërimit të përmburjes së detyrimit.”*

Sa i përket rrjedhshmërisë së afatit të parashkrimit, tek këto kërkesa, afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga fundi i vitit në të cilën arrin kërkesa për pagesë. Në rastin konkret parashkrimi borxhi nga data 01.01.2012, ka filluar të rrjedhë në fund të vitit 2012, respektivisht, me 31.12.2012, ndërsa është parashkruar me 31.12.2013.

Parashkrimi i borxhit të vitit 2013, ka filluar të rrjedhë në fund të vitit 2013, respektivisht, me 31.12.2013, ndërsa është parashkruar me 31.12.2014.

Parashkrimi i borxhit të vitit 2014, ka filluar të rrjedhë në fund të vitit 2014, respektivisht, me 31.12.2014, ndërsa është parashkruar me 31.12.2015.

Parashkrimi i borxhit të vitit 2015, ka filluar të rrjedhë në fund të vitit 2015, respektivisht, me 31.12.2015, ndërsa është parashkruar me 31.12.2016.

Kurse, propozimi për përmbarrim nga kreditori është paraqitur me 03.11.2017, që në kuptim të nenit 360 par.1 të LMD-së, kreditori për këtë periudhë kohore, propozimin për përmbarrim e ka paraqitur jashtë afatit ligjor 1 vjeçar, me ç'rast, borxhi i krijuar për vitet 01.01.2012 e deri më 31.12.2015, në shumë prej 238.25 euro është parashkruar.

Vendosja si në pikën II të dispozitivit të aktvendimit.

Gjykata konstaton se debitori detyrohet ti paguaj kreditorit shumën prej 93.00 euro për heqjen e mbeturinave, për periudhën kohore nga 01.01.2016 e deri më 30.09.2017, për shkak se borxhi i tillë për këtë periudhë nuk është parashkruar.

Kreditori me paraqitjen e propozimit për përmbarrim të datës 03.11.2017, e ka ndërprerë parashkrimin e borxhit për periudhën kohore të lartcekur nga data 01.01.2016 e deri më 30.09.2017. Kjo për shkak se parashkrimi i borxhit i vitit 2016 ka filluar të rrjedhë në fund të këtij viti, pra me 31.12.2016 dhe borxhi i këtij viti do të parashkruhej pas një viti, respektivisht me 31.12.2017, kurse kreditori propozimin për përmbarrim e ka paraqitur me datën 03.11.2017, brenda afatit ligjor 1 vjeçar, të paraparë me nenin 360 par.1 të LMD-së.

Paraqitja e propozimit ka ndërprerë parashkrimin e borxhit në kuptim të nenit 369 par.1 të LMD-së, që përcakton se: *“Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarur kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”*.

Për këtë pjesë të detyrimit, gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të aktvendimit, dhe debitori detyrohet që shumën prej 93.00 euro t'ia paguaj kreditorit.

Pretendimet tjera të debitorit të paraqitura në prapësim se debitori nuk ka pranuar asnjëherë faturat për bartjen e mbeturinave deri me datën 23.12.2021, janë të pa argumentuara dhe të pambështetura në asnjë nga shkaqet ligjore për paraqitjen e prapësimit të përcaktuara me nenin 71 par.1 të LPP-së. Gjykata thekson se përmbarimi nuk është lejuar në bazë të faturave mirëpo në bazë të ekstrakteve afariste, të cilat janë dokumente të besueshme për zhvillimin e procedurës përmbarimore. Në ekstraktin afarist është e përcaktuar debitori si konsumator i shërbimeve për heqjen e mbeturinave, në të cilën në mënyrë të detajuar janë të përcaktuara shuma e detyrimeve të debitorit, dhe koha e arritjes së tyre të cilat e bëjnë të kërkueshme kredinë e kreditorit.

Ndërsa pretendimin e debitorit se i njëjti nuk jeton në fshatin Vranoc por në Pejë në rrugën Adem Jashari, gjykata e konsideron irrelevant për vendosje ndryshe në këtë çështje juridike, për shkak se procedura përmbarimore zbatohet në mbështetje të parimit rigoroz formal i cili është parim i veçantë i procedurës përmbarimore, që manifeston shmangien nga vlerësimi faktit apo meritot i dokumentit të besueshëm dhe në këtë kuptim, gjykata është e kufizuar vetëm në vlerësimin e elementeve formale të dokumentit të besueshëm e assesit nuk shqyrton çështje që i përkasin procedurave tjera civile.

Gjykata lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancën gjyqësore dhe atë referuar vendimit të GJEDNJ-së *Saccoccia kundër Austrisë* (Aktgjykim i datës 18 dhjetor 2008), pasi pretendimet e palëve kanë qenë qarta dhe të njëjtat ngërthenin çështje ekskluzivisht ligjore të cilat nuk e kanë bërë të domosdoshme mbajtjen e seancës publike, në ndërlidhje edhe me natyrën jo komplekse e çështjes, gjykata u bazua në nenin 73 paragrafi 1 të LPP-së, i cili përcakton se: *“Gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përyjashtimisht gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit”*.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 29 par. 1 nënpar.2, nënpar.3 dhe par.3 lidhur me nenin 73 dhe nenit 77 par.1 dhe 5 të LPP-së dhe neni 341 par.1, neni 360 par.1 dhe 2, lidhur me nenin 369 të LMD-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL

2022:017081

Ep.nr.49/2022, me datë 18.12.2023.

G j y q t a r j a

Blerta KELMENDI

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë,
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh
nga dita e pranimi të aktvendimit, përmes Gjykatës
Themelore në Pejë.